



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 38 Datë 08.04.2021

VERIFIKIM I KRYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	BASHKIA DEVOLL
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP ☐ • Reklamim nga të tretë ☒
Numri i procedurave të verifikuara	1 (një)
Lloji i procedurës/ave të verifikuara	Procedurë prokurimi “E hapur”
Konstatimet kryesore	1. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 28 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 59 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, lidhur me përllogaritjen e fondit limit, në procedurën e prokurimit objekt hetimi administrativ. 2. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, lidhur me hartimin dhe argumentimin e kriterëve të veçanta, në procedurën e prokurimit objekt hetimi administrativ. 3. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 53 dhe nenin 55 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë, në procedurën e prokurimit objekt hetimi administrativ.

Masat e marra	Në bazë të neneve 13, pika 2/i, dhe 72 pika 1/dh/gj/i, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP vendosi të dënojë me gjobë 6 persona të evidentuar përgjegjës, sipas konstatimeve në vendim.
----------------------	--